

TRAJTIMI I ANKESAVE DHE PROÇESET E GJYKIMIT DISIPLINOR NË URDHRIN E MJEKËVE

Dr. Din ABAZAJ
President i UMSH-së

Duke qenë se ka një interesim të vazhdueshëm për më shumë informacion dhe transparencë rreth procesit të ankesave dhe trajtimit të tyre në Urdhrin e Mjekëve, e konsiderojmë të domosdoshme t'i përgjigjemi këtij interesimi duke sqaruar gjerësisht mediat, publikun, mjekët dhe cilindo të interesuar.

ANKESAT, TRAJTIMI I TYRE, GJYKIMI DISIPLINOR PROFESIONAL DHE MASAT NDËSHKIMORE

Urdhri i Mjekëve pranon dhe shqyrton ankasa ndaj mjekëve të cilat kanë të bëjnë vetëm me ushtrimin profesional dhe veprimtarinë mjekësore, siç janë cilësia dhe standardet e kujdesit shëndetësor që ata ofrojnë për qytetarët, si dhe sjellja profesionale e tyre në marrëdhënie me të sëmurët dhe publikun.

Urdhri i Mjekëve nuk pranon ankesa që kanë të bëjnë me kundravajtje e probleme administrative me të cilat duhet të merren administratat përkatëse.

Në Urdhër pranohen ankesa dhe denoncime nga të sëmurët, familjarët, publiku, drejtoritë e institucioneve shëndetësore, Ministria e Shëndetësië, vet mjekët, Gjykata/Prokurori, Avokati i popullit, mass-media, etj.

Shqyrtimi i ankesave, Gjykimi Disiplinor dhe masat ndëshkimore kryhen dhe merren sipas një rradhe veprimesh, procedurash dhe kriteresh të përcaktuara në Rregulloren e Gjyimit Disiplinor Profesional të Urdhrit e mbështetur kjo në Ligjin 8615, datë 01.06.2000 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë" dhe e miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve.

Ankesa e mbërritur shqyrtohet fillimisht në Kryesinë e Këshillit Rajonal të cilit i përket mjeku i paditur. Sqarohet se janë 12 Këshilla Rajonale në çdo Qark. Kryesia e Këshillit Rajonal bën verifikimin paraprak lidhur me çështjen e depozituar ku, mbledh prova, dëshmi dhe sipas rastit kryhen edhe ekspertiza me specialistë të fushës dhe, pasi bën ballafaqimin e palëve në proces, kompletton kështu Dosjen e çështjes për gjykim.

Nëse Kryesia mendon se çështja nuk përbën objekt për proces disiplinor, bën orvajtje për ta mbyllur atë me mirëkuptim e pajtim midis paleve. Në të kundërt, e relatton për gjykim në Komisionin Disiplinor të shkallës së parë pranë atij Këshilli Rajonal.

Pranë çdo Këshilli Rajonal egziston Komisioni Disiplinor i Gjykimit të shkallës së parë dhe pranë Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve ekziston Komisioni Kombëtar i Gjykimit Profesional të shkallës së dytë (Apeli).

Në çdo rast kur palët nuk janë dakord me vendimin e shkallës së parë, kanë të drejtën e rekursit në shkallën e dytë (Apeli). Vendimi i marrur në këtë komision është përfundimtar dhe i formës së prerë sa i përket kompetencave institucionale të Urdhrit. Më tej, nëse palët nuk janë dakord as me këtë vendim, kanë të drejtën e rekursit në organet e drejtësisë.

Në se konsiston shqyrtimi i një ankese?

Shqyrtimi i një ankese konsiston në verifikimin dhe evidentimin e fakteve për të përcaktuar dhe diferencuar nëse kemi të bëjmë me kequshtrim të profesionit, (d.m.th mjekim të pakujdesshëm apo kequshtrim i qëllimshëm), gabim mjekësor, sjellje profesionale të padenjë, fatkeqësi mjekësore apo aksident spitalor.

Mjekimi i pakujdesshëm, kequshtrimi i qëllimshëm dhe sjellja profesionale e padenjë kur provohen, konsiderohet faj, dhe përbën objekt për gjykim dhe masa ndëshkimore ndaj mjekut apo mjekëve të paditur, në përputhje me rëndësinë dhe rrethanat e kryrjes së veprës.

Kompetencat e Komisionit të Gjykimit Disiplinor dhe mbështetja ligjore:

Gjykimi dhe vendimmarrja e Komisionit Disiplinor mbështet në Ligjin 8615, datë 01.06.2000 "Për Urdhrit e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë" dhe ka kompetencë të japë këto masa ndëshkimore:

- a. *Vërejtje me shkrim.*
- b. *Vërejtje me paralajmërim* - çka nënkupton se në rast përsëritje i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit.
- c. Gjobë, nga 1000 – 100.000 leke .
- ç. *Propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore.*
- d. *Pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit deri në 3 vjet.*
- dh. *Përrjashtim i përkohshëm nga Urdhri i Mjekëve për një periudhë deri në 3 vjet* - çka nënkupton heqje e të drejtës së ushtrimit të profesionit për këtë periudhë.

Përveç këtyre, kur Komisioni i Gjykimit Disiplinor konstaton se mjeku nuk është kompetent dhe performant i mirë, KOMISIONI ka të drejtë të caktojë edhe detyrimin për kryerje të kualifikimeve plotësuese.

Është me rëndësi të sqarojmë dhe të garantojmë publikun e gjerë dhe mjekët se, Gjykimi Disiplinor Profesional në Urdhrit e Mjekëve është i drejtë dhe plotësisht i paanshëm

dhe i pavarur. Ai nuk ka si qëllim të vetëm ndëshkimin e mjekëve, por me anë të një gjykimi disiplinor korrekt dhe të paanshëm, **NE** synojmë të mbrojmë të sëmurët dhe publikun nga kequshtrimi i mjekësisë, si edhe të mbrojmë mjekun nga akuza të padrejta dhe abuzive, gjë që ndodh jo rrallë në praktikën e shqyrtimit dhe seleksionimit të ankesave në institucionin tonë.

Gjykimi Disiplinor Profesional, ka si qëllim dhe synim parësor edukimin profesional të mjekëve, evidentimin dhe raportimin e gabimeve mjekësore dhe masat për t'i parandaluar duke mësuar prej tyre.

Meqënëse gabimet mjekësore zënë një vend të rëndësishëm në rreziqet dhe ngjarjet e papëlqyeshme në shëndetësi, do të ishte në interes të ndaleshim në trajtimin dhe qëndrimin ndaj tyre tek ne dhe në botë.

Gabim mjekësor konsiderohet kur mjeku brënda dijeve shkencore e profesionale, si dhe mundësive që zotëron, bën maksimumin e mundshëm, për të arritur një qëllim të caktuar në të mirë të shëndetit të të sëmurit, por, për arsye të një zbatimi të gabuar të veprimit që ka planifikuar, dështon.

Gabimi mjekësor është i paqëllimshëm. Ai nuk përmban elementë të ushtrimit të pakujdesshëm për shkak të neglizhencës apo kequshtrimit të qëllimshëm.

Për fat të keq, sektori i shëndetësisë, jo vetëm këtu tek ne, por siç theksohet edhe në Deklaratën e Luksenburgut "**Mbi sigurinë e pacientit**", kudo në botë është një mjedis i rrezikut të lartë për arsye të ngjarjeve të papëlqyeshme që vijnë më së shumti nga mjekimi i gabuar sesa nga vet sëmundja. Të paktën 44 000 persona dhe më shumë në vit vdesin nëpër spitale vetëm në SHBA si pasojë e gabimeve mjekësore që mund të ishin parandaluar.

Në Raportin **e Komitetit për Cilësinë e Kujdesit Shëndetësor në SHBA**, theksohet se gabimet Mjekësore janë pasoja dhe shprehje e një sistemi mjekësor të keqmenaxhuar dhe të paaftë. Gabimet, vijon ky Raport, mund të parandalohen duke dizenuar një sistem shëndetësor në të gjitha nivelet, në mënyrë të tillë që ai të bëhet më i sigurt, që të bëhet më e vështirë për njerëzit për të bërë diçka gabim dhe, më e lehtë për ta bërë atë më mirë.

Shoqata Botërore e Mjekësisë rekomandon që puna të fokusohet në parandalimin dhe korrigjimin e dështimeve të sistemit, dhe jo në fajësimin dhe ndëshkimin e individëve. Ndërkaq duhet të ketë një kulturë mosdënimi për gabimet mjekësore të raportuara.

Në një sistem shëndetësor të mirëorganizuar, të mirëfinancuar dhe të mirëmenaxhuar i cili të mund t'i krijojë mjekut kushte e mundësi për të azhornuar e për të ruajtur aftësitë dhe dijet e tij profesionale, teknologji bashkëkohore moderne për të diagnostikuar e mjekuar saktë e drejtë, t'i ofrojë mjedise optimale për të punuar, udhëzues klinikë e protokolle mjekimi, rregulla e rregullore me kërkesa strikte për zbatimin e tyre, siguria e pacientit do të ishte maksimale, kequshtrimi dhe gabimet mjekësore shumë më pak të mundshme.

Cili është, dhe si duhej të ishte qëndrimi i të sëmurit dhe i familjarëve ndaj mjekut që gabon?

Në të gjitha ankesat e mbërritura në Urdhrin e Mjekëve për diagnozë dhe mjekim me përfundime të papritura dhe të padëshirueshme, kërkohet me insistim shpallja fajtor e mjekut dhe ndëshkimi i tij, madje, siç e dimë, është kaluar edhe në ushtrim të dhunës fizike ndaj tyre, ndërkohë kur akoma askush nuk ka hetuar dhe nuk e ka konfirmuar një pretendim të tillë të qytetarëve, nëse mjeku është apo jo fajtor.

Asgjë nuk përfiton qytetari i dëmtuar, nëse mjeku ndëshkohet, përveç një hakmarrje primitive me prejardhje kanunore. Por as gabimet mjekësore nuk parandalohen, as sistemi përmirësohet.

Kur me prova e fakte konfirmohet se dëmi i shkaktuar apo fatkeqësia e ndodhur ka ardhur si pasojë e kequshtrimit, e gabimit mjekësor apo si përgjegjësi institucionale, çfarëdo qoftë e prejardhur nga shërbimi mjekësor, i sëmuri apo familjarët e tij, në vend se të kërkojnë ndëshkimin e mjekut, do të ishte më llogjike dhe arsyeshme të kërkojnë dëmshpërblim për dëmin e pësuar.

Një gjë e tillë bëhet e mundur vetëm me daljen e Ligjit Për Sigurimin e Mjekëve dhe Institucioneve Shëndetësore. Dëmshpërblimi në këtë rast do të bëhej nga kompanitë e sigurimeve.

Detyrimi i mjekëve në kontekstin e problemit që po shqyrtojmë

Ajo ç'ka mjekët duhet të ndreqin detyrimisht në punën e tyre në marrëdhënie me të sëmurët dhe familjarët është komunikimi dhe informimi i tyre me hollësi mbi veprimet mjekësore që iu propozohet të kryejnë, dobitë dhe rreziqet që ato mbartin, të cilat i sëmuri ka të drejtë t'i pranojë ose refuzojë, duke nënshkruar për vendimin që merr.

Gjithashtu, qytetarët kanë të drejtë të informohen, dhe detyrimisht duhet të informohen me transparencë, për gjithçka që ka ndodhur në trajtimin e tyre dhe pse ka ndodhur.